

Shtojca 15

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Pogradec, më 06.04.2021

Për: Operatorin Ekonomik Al-Dok SHPK, me NIPT: J64103601Q, me adrese "Korce Udenisht Komuna Udenisht, Qaf Thane, prane hotel Odesa", perfaqesuar nga Administratori i Shoqërisë z. Ajas Dokollari.

Procedura e prokurimit: "Kërkesë për Propozime" - "Punë" - "Prokurim elektronik" - "Me lote".

Numri i referencës së lotit II: REF-89433-03-09-2021

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Loti II: "Mirembajtje kanali ujites Rezervuari Plloce e vjeter - ish pularija Starove", me fond limit 870 384 (Teteqind e shtatedhete mije e treqind e tetedhete e kater) lekë.

Publikime të mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 38 datë 16 Mars 2021

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

Çmimi më i ulët X

Oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. "LEKA" SHPK **NIPT: J641036310**

Vlera pa TVSH: 549 380 (Peseqind e dyzete e nente mije e treqind e tetedhete) Leke

2. AL - Dok SHPK **NIPT: J64103601Q**

Vlera pa TVSH: 545 490 (Peseqind e dyzete e pese mije e katerqind e nentedhete) lekë.

3. INFINIT SHPK **NIPT: J74304623M**

Vlera pa TVSH: 607 840 (Gjashteqind e shtate mije e teteqind e dyzete) lekë.

4. **BENAKS - 94 SHPK**

NIPT: J73804663H

Vlera pa TVSH: 791 565 (Shtateqind e nentedhjetë e një mijë e pesëqind e gjashtedhjetë e pesë) Lekë

5. **JOKLEN&CO SHPK**

NIPT: K84322601F

Vlera pa TVSH: 731 888 (Shateqind e tridhjetë e një mijë e teteqind e tetëdhjetë e tete) lekë.

Eshtë skualifikuar ofertuesi i mëposhtëm:

1. **"LEKA" SHPK**

NIPT: J64103631O

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik **LEKA SHPK, NIPT: J64103631O**, rezultoi se dokumentacioni i paraqitur në S.P.E, NUK është në përputhje me kriteret e vendosura në DST, duke i parashtruar si më poshtë vijon:

1. Shtojca 1/1, NUK është plotësuar në mënyrën e saktë, pasi NUK është selektuar asnjë nga opsionet 6/a ose 6/b.

2. Nuk dëshmon se ka paguar detyrimet tatimore, pasi vertimi i dorëzuar në S.P.E mban datën 15.02.2021, ndërkohë hapja e ofertave është bërë me datë 23.03.2021. Detyrimisht, referuar datës së hapjes së ofertave O.E duhet të kishte shlyer detyrimet tatimore për gjithë muajin shkurt 2021.

3. Vertetimi i OSHEE, Nr. 97 Prot, datë 02.03.2021, përmban disa arsye për skualifikim, si më poshtë:

3.1 Përdoruesi figuron z. Arben Abrashi dhe jo shoqëria apo administratori i saj.

3.2 Referuar datës së hapjes së ofertave 23.03.2021, O.E duhet ta kishte paguar muajin shkurt 2021, pasi afati i fundit për kryerjen e pagesës së energjisë, pa kamata është data 20.03.2021.

Pra, O.E me vertetimin e dorëzuar nuk konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri, çka vjen në kundërshtim me kriteret e DST, dhe është arsye për skualifikim.

4. O.E LEKA SHPK, nuk dëshmon që ka të punësuar me kontratë pune dhe diplomën përkatëse, një inxhinier ndërtimi, pasi administratori i shoqërisë kryen veprimtari administrative të shoqërisë, dhe nuk merr pjesë në proceset e zbatimit të punimeve.

5. Referuar ekstraktit te shoqerise, O.E LEKA SHPK, deri me date 05.01.2021, ka pasur si adrese sekondare vendndodhjen "Korce; KORÇE; Korçe; ; KORCE; Ish dega e Farnave me nr pasurie 6/390, zona kadastrale 8562. Ne permbushje te kriterëve te DST, O.E duhet te kishte dorezuar vertetim nga Bashkia Korce qe ka paguar taksat vendore per vitin 2020, ne kete bashki. Mosdorezimi i ketij vertetimi, perben shkas per skualifikim.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik Al-Dok SHPK, me NIPT: J64103601Q, me adrese "Korce Udenisht Komuna Udenisht, Qaf Thane, prane hotel Odesa", perfaqesuar nga Administratori i Shoqërisë z. Ajas Dokollari, se oferta e paraqitur, me një vlerë pa TVSH prej 545 490 (Peseqind e dyzete e pese mije e katerqind e nentdhjete) lekë, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Ndermarrjes se Mirembajtjes se Infrastrukturave dhe Puneve Publike, Bashkia pOGRADEC*, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (Pese) ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi ne buletin e APP-se.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do te ndiqen procedurat siç parashikohet në Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 29.03.2021

Ankesa: JO

[TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR]
ENTON BERBERI